

VENDIM
Nr. 666, datë 29.7.2015

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË
SPITALLË, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit, me sipërfaqe 501.9 (pesëqind e një pikë nëntë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shtirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë zonë janë:
 - prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
 - tregtare dhe magazinim mallrash;
 - shërbime.
 4. Periudha e funksionimit të zonës është 99 vjet.
 5. Përzgjedhja e zhvilluesit të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.
 6. Si fazë e parë të përzgjidhet zhvilluesi për një sipërfaqe prej 212.8 (dyqind e dymbëdhjetë pikë tetë) ha, sipas hartës dhe numrave të pasurive, bashkëlidhur këtij vendimi.
 7. Kriteret, në bazë të të cilave vlerësohen zhvilluesit, do të jenë:
 - propozimi i projektit teknik;
 - ndikimi mjedisor;
 - ndikimi social;
 - kohëzgjatja e punimeve;
 - kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.
 8. Vendimi nr. 72, datë 28.1.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës ekonomike, me statusin zonë e lirë në Spitallë, Durrës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 391, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike” në Spitallë, Durrës”, të ndryshuar”, dhe vendimi nr. 391, datë 21.2.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike” në Spitallë, Durrës” shfuqizohen.
 9. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E PASURIVE QË DO
PËRFSHIHEN NË "ZONËN E
TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK" FAZA
E PARË**

<i>Nr.</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. pasurie</i>	<i>Lloji i pasurisë</i>
1	8,517	36	arë
2	8,517	37	arë
3	8,517	45	arë
4	8,517	46	arë
5	8,517	47	arë
6	8,517	48	arë
7	8,517	49	arë
8	8,517	50	arë
9	8,517	63	arë
10	8,517	64	arë
11	8,517	65	arë
12	8,517	66	arë
13	8,517	78	arë
14	8,517	79	arë
15	8,517	80	arë
16	8,517	81	arë

**LISTA E PASURIVE QË DO
PËRFSHIHEN NË "ZONËN E
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK"**

<i>Nr.</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. pasurie</i>	<i>Lloji i pasurisë</i>
1	8,517	22	arë
2	8,517	23	arë
3	8,517	34	arë
4	8,517	35	arë
5	8,517	36	arë
6	8,517	37	arë
7	8,517	45	arë
8	8,517	46	arë
9	8,517	47	arë
10	8,517	48	arë
11	8,517	49	arë
12	8,517	50	arë
13	8,517	63	arë
14	8,517	64	arë
15	8,517	65	arë
16	8,517	66	arë
17	8,517	67	arë
18	8,517	76	arë
19	8,517	78	arë
20	8,517	79	arë
21	8,517	80	arë
22	8,517	81	arë
23	8,517	101	arë
24	8,517	102	arë
25	8,517	103	arë
26	8,517	104	arë
27	8,517	105	arë
28	8,517	147	vaskat




SPITALLA

1:20 000

Sipërfaqja - 212,8 Ha

- Rruga Kryesore
- Superstradë
- Rrugë dytësore
- - - Kufijtë e zonës
- Det
- Portat e zonës



-  Kufiri i zonës
-  Rrugë 4 korsi
-  Porta hyrëse dhe dalëse të zonës

Sipërfaqja 501.9 ha